

Albanian language as a fundamental ingredient of identity of the Albanians in Italy

Abstract: *The essay sees language as the most important element of the identity of the Albanians in Italy starting with the first Arbëresh emigration in the second half of the 15th century, to the most recent one at the beginning of the 1990s.*

The first part of the essay is a historic description and focuses on the foundation of the first Arbëresh settlements in southern Italy; the most meaningful elements shaping Arbëresh identity; the major role which the Arbëresh played during the National Awakening; socio-stilistic status of the Arbëresh language in the framework of the languages and dialects spoken nowadays in Italy until the meeting point with the "brothers coming from overseas" when awareness of distinction between Arbëresh and Shqiptar identities arose.

The second part of the essay deals with the status of the Albanian language; the recent Albanian emigrants to Italy; their discrimination; the main factor influencing the process of the language assimilation marking the beginning of the process of the identity assimilation. Data attained from a questionnaire of 70 individuals interviewed display a wavering and brittle ethnic identity of the Albanians residing in Italy nowadays.

Keywords: *Ethnic identity, Albanian language, discrimination, emigration.*

Migrimi i parë

Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XV deri në gjysmën e shek. XVIII (Villa Badessa), nën presionin e pushtimit osman në Ballkan, fillon migrimi masiv i shqiptarëve në Italinë e jugut. Lindin kështu kolonitë e para arbëreshe në Itali. Kemi të bëjmë me një popullsi të pjesës jugore albanofone (Çamëri, More) që i përkasin dialektit toskë. Pjesa më e madhe e këtij migrimi dokumentohet pas vitit 1468, me vdekjen e Gjergj Kastriot Skënderbeut, heroit kombëtar të rezistencës kundër pushtimit osman.

Sipas Altimarit (1986) shqiptarët në Itali dëshmohen që në shek XIII e XIV, bërthama të tjera qenë vendosur në Puglia, Calabria e Sicilia, nëpër feudet që i ishin dhënë Skënderbeut dhe komandantëve të tjerë

shqiptarë nga Alfonso d'Aragona I për ndihmën ushtarake që i kishte dhënë kundër baronëve vendorë. Pas rënies së Shkodrës (1479) kemi migrime të tjera shqiptarësh në Venezia, ku u krijua një koloni e rëndësishme me intelektualë të shquar si humanistët Giovanni, Paolo, Andrea Gazulli, Niccolò Tomeo, Marino Becichemi, skulptori Alecci, Campsa, Carpaccio, Marco Basaiti (Altimari 1986, Nadin 2012).

Sikurse theksojnë historianët (De Leo, 1981), kushtet socio-ekonomike të jugut, veçanërisht të Kalabrisë të shek. XV qenë mjaft të degraduara dhe të goditura nga një varg katastrofash natyrore, arsye pse baronët vendas favorizonin ngulitjen e shqiptarëve në to. Megjithatë (cf. Altimari, 1986), mund të flitet për komunitete të mirëfillta shqiptare, me besimin e tyre fetar, festat, këngët dhe gjuhën, vetëm fund të shek. XV. Nga këndvështrimi i besimit fetar këto komunitete i përkisnin ritit bizantin në gjuhën greke, ndaj u desh që të viheshin nën udhëheqjen e kishës katolike, pa hequr dorë nga identiteti i tyre religjioz bizantin. Kjo besnikëri nuk qe vetëm e besimit, por paraqiste edhe një mekanizëm rezistence ndaj asimilimit dhe ruajtjes së identitetit kulturor, thekson Altimari.

Përeç fshatrave të Molise-s, Lucania-s dhe Puglia-s që e braktisën ritin bizantin, shumë të tjera e ruajtën: deri në shek. XVI këto komunitete ishin nën juridiksionin e Patriarkatit Bizantin të Ohrit dhe mbajtën raporte të vazhdueshme me të. Me kundërreformën dhe normat disiplinore të vendosura nga Concilio di Trento (1546-63) u synua të eliminoheshin gjurmët e fundit të juridiksionit ortodoks dhe, në vitin 1564, Pio IV i vendosi këto komunitete nën drejtimin e ipeshkvive dhe dioqezave latine. Vetëm nën udhëheqjen e Clemente XII u themelua Kolegji Corsini i Shën Benediktit të Ullanos (Collegio Corsini di S.Benedetto Ullano (1732)) që pastaj u transformua në Kolegjin e Shën Adrianos, San Demetrio Corone (1794), dhe seminari greko-shqiptar i Palermos (1734) për komunitetet e Sicilisë. Këto kolegje patën një rol fundamental në shkollimin jo vetëm të klerit, por edhe të intelektualëve arbëreshë; ata mes të tjerash bënë të mundur formimin dhe ruajtjen e trashëgimisë historiko-kulturore të komuniteteve arbëreshe në të cilat u formua një fill i përkushtimit civil dhe intelektual progresist, i ndjeshëm ndaj lirisë dhe demokracisë së shoqërisë italiane.

Komunitetet arbëreshe (Faraco 1976, Gambarara 1980, Altimari e Savoia 1994) shfaqin një dinamizëm kulturor të parakohshëm dhe një vetëdijësim etnik origjinal. Ky identitet gjen shprehje në veprën e intelektualëve që nga shek. XVI që i bëjnë komunitetet arbëreshe qendra të privileguara të kulturës shqiptare. Themelimi i Kolegjeve greko-arbëreshe të Kalabrisë dhe të Sicilisë gjatë shek XVIII dhe frymëzimi nga kultura europiane që lulëzonte në ambientin napolitan krijojnë kushte për militantizmin e intelektualëve arbëreshë në lëvizjen e Rilindjes italiane (Altimari, 1986).

Veçanërisht tiparet e demokracisë që kanë të bëjnë me lirinë e individit dhe ngrihen kundër absolutizmit të perandorive ushqyen këtë klasë intelektualësh me frymëzimin iluminist që u reflektua gjatë Rilindjes Italiane (Pasquale Scura e Luigi Giura, ministra në qeverinë e Garibaldit, Agesilao Milano, Attanasio Dramis, Francesco Crispi). Përmendim rastin e Agesilao Milanos, një ushtari kalabrez me origjinë arbëreshe që në 1856 i bëri atentat mbretit të Napolit dhe për këtë u lëvdua nga monarkët piemontezë. Kur në 1860 Garibaldi mbërriti në Napoli, një nga aktet e tij të para ishte dekreti me të cilin do i paguante nënës së Agesilaos një pension mujor prej 30 dukatësh dhe motrave një pajë prej 2000 dukatësh. Kujtojmë se të gjithë nxënësit e Kolegjit të Shën Adrianos morën pjesë në betejën e Voltornos me Garibaldin dhe gjithashtu në përgatitjen e Rilindjes në Shqipëri, veçanërisht pas Lidhjes së Prizrenit në 1878. Kësaj periudhe i përket De Rada, promotor i një letërsie të re, të angazhuar dhe të ndikuar nga modelet europiane e cila e tejkaloi letërsinë folklorike tradicionale apo atë religjioze e didaskalike. Këngët e Milosaos paraqesin veprën e parë të letërsisë së mirëfilltë reflektive në letërsinë shqipe.

Statusi i arbërishtes

Të dhënat mbi përdorimin e shqipes te komunitetet arbëreshe janë të pjesëshme dhe ad hoc, duke qenë se që nga themelimi i Republikës nuk janë bërë më dokumentime shkencore. Kërkimet e bëra nga Klaus Rother në 1966, të cilat i sjell Gambarara (1980), japin disa të dhëna: 70% e komunitetit flet arbërisht, 30% është italofone apo dialektofone. Mbi këto të dhëna Altimari (1986) na jep një përllogaritje që numri i qytetarëve arbërishtfolës që jetojnë në qendrat historike të jetë të paktën 90 000. Numri rritet në 200000 nëse llogarisim arbëreshët që emigruan në zonat industriale apo urbane në veri të Italisë.

Është e rëndësishme të theksojmë se arbërishtja ka kaluar nëpër proceset që kanë kaluar edhe gjuhë të tjera minoritare në Itali, veçmas pas LIIB, si pasojë e mungesës së mekanizmave mbrojtës ndaj gjuhëve minoritare në procesin e arsimimit masiv (Bolognari, 1989). Po ta krahasojmë gjendjen e komunitetit arbëresh në Itali me atë arvanitas në Greqi, shohim se arbëreshët e kanë ruajtur identitetin e tyre gjuhësor dhe kulturor në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Arvanitasit kanë pësuar një proces të fortë asimilimi edhe për shkak të forcës së identifikimit religjioz, ndërsa arbëreshët kanë pasur mundësi më të mëdha të mbrojtjes, edhe për shkak të besimit të ndryshëm fetar dhe kulturor që lidhet me ruatjen e ritit grek dhe me institucionin e dy Eparkive, asaj të Lungros dhe asaj të Horës.

Duke filluar nga vitet '50 të shekullit të kaluar kanë ndodhur iniciativa të rëndësishme, si lindja e shoqatave, shtëpive botuese, revistave dhe seminareve, u intensifikuan kontaktet mes universiteteve italiane dhe

atyre shqiptare, Koliqi themeloi revistën Shejzat në universitetin e Romës, pastaj u themeluan revistat e tjera si Zjarri, Katundi Ynë, Zëri i Arbëreshvet etj. Këtyre viteve u përkasin hulumtimet e Gangales në Kalabri, hulumtimet mbi narrativën tradicionale të Luca Perrones, Instituti i Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Shqiptare “Rosolino Petrotta”, Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë shqiptare në Palermo. Roli i këtyre instrumenteve bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm për kulturën arbëreshe, ndërkohë që katedrat universitare marrin rolin themelor në raportin me Shqipërinë, me kulturën, gjuhën, shkrimtarët etj.

Gjendja gjuhësore në Itali karakterizohet nga prania e varieteteve jostandarde që përfshijnë si dialektet lokale, ku përfshihet dialekti sard, ladin, friulian, frankoprovençal e provençal, ashtu edhe varietetet e vjetra aloglote si ai arbëresh, grak, kroat, slloven, gjerman, cigan. Arbërishtja konsiderohet si varietet aloglot në skemën linguistike italiane, ashtu sikurse greqishtja, kroatishtja, sllovenishtja, gjermanishtja dhe gjuha e romëve. Kushtet e përdorimit të gjuhëve aloglote përkojnë me ato të dialekteve lokale, ku përfshihen edhe dialektet si ai sard, ladin, friulan, frankoprovençal e provençal (De Mauro et.al. 1980, Salvi 1975, Telmon 1992) dhe po ashtu kanë edhe të njëjtin status socio-stilistik. Në zona të ndryshme të vendit gjallojnë edhe kushte gjuhësore të karakterizuara nga bilinguizmi dhe diglosia. Përballë kësaj situate shkolla italiane ka pasur qendrim të ngurueshëm për të pranuar një konceptim plurilinguistik në arsim. Ajo ka shprehur stereotipin kulturor të vjetër, por vital, të lidhjes së gjuhës me kombin duke i interpretuar qendrimet kulturore dominante të patolerueshme ndaj pranisë së kushteve të ndryshme gjuhësore dhe kulturore (Sobrero, 1974). Në anën tjetër, që nga përfundimi i LIIB programet shkollore janë rregulluar me ligj duke u konsideruar materie nën kompetencë të posaçme të shtetit. Kjo gjë ka sjellë një orientim të centralizuar, të orientuar nga asimilimi dhe uniformiteti kulturor, që nuk ka ditur të interpretojë vlerën e lirisë që shprehet në diferencimin linguistik. Orientimet juridike të shtetit kanë riprodhuar një drejtim sa indiferent aq edhe jotolerues ndaj pluralizmit kulturor (Carrozza, 1992).

Analizat e Gangale-s mbi komunitetet arbëreshe të Kalabrisë qendrore tregojnë për një situatë gjuhësore shumë të kompromentuar. Shkaku kryesor i kësaj gjendjeje është braktisja e komunikimit në arbërisht në familje. “Familja arbëreshe prej shekujsh është e demoralizuar, e kompleksuar, e pushtuar nga alogjene dhe aloglote. Është e kuptueshme që në shumë pika të arkipelagut arbëresh, për të dalë nga situata e krijuar nga organet shtetërore mohuese, familja arbëreshe nuk diti rrugëzgjidhje tjetër, veçse të bënte harakiri, duke bërë gjenocidin e vetë.” (Gangale, 1976:27). Bazuar në të dhënat e elaboruara te Bolognari, 1986, kjo situatë, të paktën në shumë qendra arbëreshe, pak nga pak ka ndryshuar. Transformimet sociale

dhe ekonomike që kanë ndodhur në Itali në dhjetëvjeçarët e fundit kanë përcaktuar një qendrim shumë më të ndryshëm ndaj gjuhëve jo standarde dhe një rivlerësim kompleks të vlerës së tyre si element i identitetit.

Ligji mbi mbrojtjen e gjuhëve minoritare parasheh si pikë kyçe mësimdhënien e arbërishtes dhe në arbërisht në arsimin e obliguar. Duke u orientuar drejt varietetit lokal shkolla ka rastin që të pasqyrojë elementë themelorë të lirisë dhe tolerancës. Në të kundërt, orientimi drejt shqipes apo standardeve artificiale do të riprodhonte shtresëzimin e vlerave, skemave diglose dhe asimetrive linguistike që përkojnë me raportet e pushtetit brenda shoqërisë, të cilat ligji 482 dhe rezoluta e Komunitetit Europian kërkojnë që ta tejkalojnë. Në fakt, përqaftimi i normave ortografike e gramatiko/leksikore i shqipes në disa revista si psh. Rilindja Arbëreshe merr një vlerë të qartë idologjike.

Modelet e analizës së teorisë gjuhësore tregojnë se konservatorizmi lingistik që bazohet në një konceptim romantik e tërësisht retorik, i cili mund të ketë efekt legjitimitetin e braktisjes së varieteteve jostandarde, është një pozicion ideologjik. Çdo varietet gjuhësor është një sistem ku rregullat dhe strukturat realizojnë principe të aftësisë për gjuhë. Përveç kësaj, raporti që lidh një gjuhë me kushtet socio-kulturore të komunitetit që e përdor drejtohet nga një kapacitet natyror evolutiv. Sipas kësaj perspektive mësimdhënia e arbërishtes është ajo që duhet synuar nga shkollat, si një gjuhë e gjallë dhe që realisht flitet, përdoret, njësoj sikurse ndodh me gjuhët e tjera në kushtet e ndërveprimit gjuhësor përbrenda një grupi social (Famiglietti, 1979).

Migrimi i dytë

12 korrik 1991, mbërrijnë në portin e Brindizit pesë tragete me 4553 shqiptarë. Anijet e ndryshkura përplot me shqiptarë që u shfaqën në brigjet e frikësura të Puglias ishin prova e asaj skeme, me natyrë thellësisht mitologjike, që bazohej në një logjikë bipolare: nga një anë parajsa, nga tjetra ferri (Devole, 2015:31). Fillon kështu epoka e re e migrimit shqiptar në Itali. Fillimisht Italia si edhe shtetet e tjera europiane tregojnë anën e tyre humane, mikërpritjen dhe përqendrohen në përcaktimin e statusit të tyre si refugjatë politikë apo ekonomikë, por është e vështirë për autoritetet lokale të vendosin përpara njerëzve të uritur e rraskapitur.

Duke mos u futur në histori, përqendrohemi te takimi i arbëreshëve me “vëllezërit e ardhur nga përtej deti” dhe pyetja e parë që na vjen në mendje është pse kaq pak shqiptarë në dy zonat Sicili e Kalabri, ku jetojnë më shumë se 100000 arbëreshë?

Këtu prekim çështje që janë njëkohësisht kulturore, sociale dhe ekonomike: për të kuptuar qendrimin kompleks të arbëreshëve ndaj të ardhurve të rinj mund të na vijë në ndihmë arsye sociologjike, por edhe një

lloj psikologjie e thellë e popullsisë arbëreshe të Sicilisë dhe Kalabrisë. Janë shumë domethënëse fjalët e kryetarit të Lungros në korrik të 1990 kur Lungro propozojë të ishte një qendër ku të grumbulloheshin të ardhurit nga Shqipëria. “..Sigurisht që kemi pothuajse të njëjtin gjak, por nuk kemi struktura për t’i pritur, perspektiva për t’iu ofruar”. Pastaj arbëreshi që për ditë me radhë ishte quajtur si mbajtës i flamurit të vëllazërisë vazhdon: Unë një nga këta emigrantë mund ta mbaja edhe në shtëpinë time. Por vetëm për pak. Sigurisht që nuk mund t’u premtoj atyre vende punë se kjo do të thotë që do t’ua hiqja bashkëvendasve të mi.

Edhe në planin kulturor gjendja nuk u paraqit më ndryshe. Citojmë peshkopin e Lungros, Monsignor Ercole Lupinacci: Sigurisht që këta emigrantë do të ishin më mirë te ne sesa në kampet e refugjatëve. Mes nesh, në familjet tona do gjenin një lloj ngjashmërie në gjuhë e tradita. Por për sa kohë e mbi cilën bazë? Jo, më mirë të kalojmë menjëherë me zgjidhje më praktike, USA, Canada etj.

Përvojat e pakta mes arbëreshëve dhe emigrantëve shqiptarë nuk linin shpresa. Shpejt në arat e punës do të lindnin konflikte mes emigrantëve të punësuar dhe vendasve. Këto konflikte dëshmojnë për vështirësinë e pranimit të të sapoardhurit që prezantohej me të gjitha karakteristikat e “tjetrit” nga i cili duhej mbajtur më shumë distancë sesa solidarizim. Nga ana tjetër vëreheshin vështirësitë e këtij “tjetrit” për t’u bërë i pranueshëm: një si lloj profecie po verifikohet, nuk do ia dilte të bënte të pranueshme sjelljen dhe mënyrën e jetës së tij të përditshme. Që këtu fillon dështimi i integritetit të shqiptarëve në nëpër gjithë vendin tonë në atë periudhë. Tentativa integrimi u dështuan në zonat e veriut edhe pse të ndryshme për nga gjuha e kultura, ndërkohë që dështuan (përjashtohen pak raste) në zonat e jugut të Italisë ku pritej të ndodhte e kundërta.

Ajo që mund të nxjerrim si përfundim nga ky evokim i fakteve është se thirrja në identitetin etnik e kulturor të përbashkët nuk solli asgjë në terrenin konkret të solidarizimit, as në perspektivën utopike që mund të pritej nga kulturat minoritare. Ajo çka ndodhi me shqiptarët e Lungros, pasi që i larguan nga katundi arbëresh, na bën të mendojmë se nuk mund të bazohemi në një kulturë të përbashkët për të krijuar një vëllazërim real.

Për Durkheim dimensionin themelor i një shoqërie ishte i qartë, ai e quante “vetëdije kolektive”. Vetëm se kjo vetëdije nuk përcaktohet një herë e përgjithmonë dhe nuk vlen për çdo vend të botës dhe për çdo kohë: por është e lidhur ngushtë me ndarjen sociale të punës. Solidariteti mekanik durkeimian bazohet mbi modele të përbashkëta vlerash e sjelljesh, që kishin një lloj varësie nga gjaku, gjuha, universet kulturore paraekzistuese; në të kundërt “solidariteti organik” është një lloj integrimi që zhvillohet në shoqëritë moderne në bazë të ndërvarësisë mes individëve dhe bashkësive të ndryshme; që krijohet nga ndarja e punës sociale. Pra nuk mjafton

kultura e përbashkët, që merret si fetish që duhet ruajtur, por është kyçja në botën e punës që siguron proceset e integritetit gjithmonë e më të padhimbshme e më reale.

Identiteti dhe shoqëria

“Identiteti është një element kyç i realitetit subjektiv dhe, si gjithë realiteti subjektiv, është në relacion dialektik me shoqërinë. Identiteti formohet nga proceset sociale.” (Berger, Luckmann, 1991:194). Si i tillë identiteti i popujve, apo identiteti etnik që i lidh njerëzit në bazë të origjinës së lindjes, nuk përcaktohet një herë e përgjithmonë, por ndërtohet në kohë, modifikohet apo riformësohet. Identiteti arbëresh i ndërtuar për pesë shekuj në Itali nuk mund të ketë aq shumë të bërëbashkëta me atë shqiptar, të dyja grupet kanë zhvilluar një vizion për botën dhe për jetën të ndryshëm. Megjithatë literatura i është qasur studimit të identitetit nga metoda të ndryshme epistemologjike sa që sot është krijuar një konfuzion rreth termit. Një nga qasjet më konfuze e më problematike për analizë është pikërisht versioni ‘i lehtë’ i ndërtimit, i cili thotë se identiteti është i shumëfishtë, fluid dhe gjithmonë ndërron, gjë që vë në dyshim veprueshmërinë dhe dobinë e tij si një objekt hulumtimi (Vathi, 2015: 38). Sociologë si Brubaker dhe Cooper (2000) i kanë paraprirë idesë së Vathit, madje kanë shkuar më larg duke e akuzuar Erisksonin (1968) për nisjen e sagës për krijimin e termave dhe modeleve konfuze që e bënë identitetin një koncept të paqartë për analizë (cf. Vathi 2015).

Shqiptarët dhe shqipja sot në Itali

Në gjithë konfuzionin që është sot në literaturë rreth përcaktimit të identitetit, na duhet të përqendrohemi te faktorët dhe karakteristikat të cilat ndikojnë te individët për t’u identifikuar si pjesë e një grupi. Cili është identiteti i shqiptarëve sot në Itali? Nëse është e vërtetë që gjuha është një nga përbërësit fundamentalë të identitetit të një komuniteti, atëherë kjo vlen dyfish për Shqipërinë, ku gjuha pati rol vendimtar në formimin e vetëdijes kombëtare në periudhën e Rilindjes (Devole, 2006:176). Në fakt Rilindja Kombëtare shqiptare është projekti më i madh kulturor dhe patriotik i shqiptarëve që i dalloi shqiptarët nga Perandoria Osmane, projekt që u drejtua nga intelektualët, shumica e të cilëve jetonin jashtë vendit. Gjuha dhe kultura popullore ishin dy elementët mbi të cilat u ngrit gjithë procesi i vetëdijësimit kombëtar (Morgan 2002, Malcolm 2002, Vathi 2015). Shqiptarët u lidhën me Shqipërinë në bazë të ‘lidhjes së gjakut’, gjuhës dhe kulturës, dhe jo të religjionit, veçanërisht me besimin më të ri i cili lidhej me Perandorinë Osmane (Morgan 2002). Nacionalizmi shqiptar bazohet në mite të rëndësishme historike dhe të origjinës gjeografike, të homogenitetit etnik dhe kulturës së pastër, të luftës përmanente nacionale

dhe të indiferencës ndaj religjionit (Vathi, 2015: 43). Ndërkohë që gjatë 50 vjetëve të dikaturës komuniste u përzgjedhën disa nga elementët kuturorë të së kaluarës duke përjashtuar religjionin, familja dhe lidhjet fisnore mbetën instituti kryesor i kulturës shqiptare.


Me rënien e komunizmit në Shqipëri një mit i ri u krijua në shoqëri, ai i Perëndimit, i cili u shfaq si toka e premtuar që i priste shqiptarët, ajo ku secili jetonte në liri e demokraci. Kontakti i parë real me Perëndimin i bëri shqiptarët të përballeshin me një mit tjetër të 'shqiptarit' krijuar për ta nga ekskluzivisht nga mediat, që mbajtën rolin kryesor në diskriminimin e emigrantëve. Shqiptari/ja e pa shqiptarin/en si të pistë, injorant/e, përdhunues, prostitutë, hajdut/e, të/e paaftë. Fillon kështu procesi i zhvlerësimit apo i fshehjes së identitetit.

Klara (grua 41 vjeçe, Firenze): Kur ai [i biri] shkante në shkollë kur ishte i vogël, u kthye nga shkolla duke qarë. Thoshte, 'Ata më thërrasin *Albanese*. Nuk e di pse më shajnë! Sepse në shtëpi ne i thoshim djalit se ne ishim *shqiptarë*, m'u desh t'ia shpjegoja se *Albanese* ishte përkthimi në itashisht i fjalës *shqiptar*. Sikurse italianët që në USA quhen *Italiani*. Atëherë im bir e kuptoi se çfarë kishte ndodhur. Sepse duke dëgjuar TV e të tjerët, ai kishte menduar se *Albanese* do të thoshte *kriminell*!' (Vathi 2015: 153)

Por si duket sot gjendja e shqiptarëve në Itali? Nga statistikatat e ISTAT, në 1 janar 2017, qytetarët e huaj në Itali janë rreth 5 milion, kryesisht të vendosur në qendër dhe në veri të vendit, shqiptarët përbëjnë 9.3% të tyre, pra rreth 465000 rezidentë të rregullt. Të dhënat e ISTAT (2012) tregojnë se në Itali qenë 380000 shqiptarë, italishtja flitej në familje 37,2 %, me miqtë 65,9%, në punë 91.8%. Shqiptarët kanë përqindjen më të ulët në pjesëmarrjen në kurse të italishtes, 8%, ndërkohë që 46,4 % e tyre deklarohen se e dinin italishten sa për t'u kuptuar kur mbërritën në Itali. Nga këto të dhëna vërejmë se fluksi i shqiptarëve që vijnë në Itali nuk është ndërprerë edhe pse në numër shumë më të vogël.

Nga të dhënat që ne vetë kemi mbledhur mbi një korpus me shtatëdhjetë emigrantë shqiptarë në Itali, nga mosha 8 deri 64 vjeçe, në një periudhë tre mujorëshe (qershor-gusht 2018), të dhënat e ISTAT gjejnë shpjegim të përgjigja e emigrantëve ndaj pyetjes: A mendoni të ktheheni në Shqipëri? 64% e të intervistuarëve përgjigjet jo, 71% janë gra dhe 55% burra. Shqiptarët ende nuk e shohin Shqipërinë si një vend të mundshëm për të jetuar, ndërkohë që ka filluar fluksi i një emigrimi të ri të tyre drejt vendeve europiane me ekonomi më të zhvilluar. Me këtë gjendje jostabile të një pjese të shqiptarëve në Itali dhe Greqi lidhet edhe një interes

MENDONI TË KTHEHENI




shkencor i identitetit të tyre të cilin do ta bartin me vete ne vendet e reja.

Nga një përvojë si ndërmjetëse kulturore në shkollat fillore e të mesme në Livorno për integrimin në shkollë të fëmijëve shqiptarë që kishin emigruar nga Greqia në Itali, e vetmja gjuhë komunikimi ishte shqipja, edhe pse për ta ishte në shumicën e rasteve pasive. Pas katër muajsh punë me nga 2-4 orë në javë, me Noemin, 6 vjeçe, e lindur në Greqi, u bë më i lehtë komunikimi në italisht sesa në shqip. Nëse do të krahasonim Noemin me motrën më të madhe Ester (10 Vjeçe) ishte se Ester kishte një zotërim më të mirë të shqipes gjë që e ndihmoi të përvetësonte më lehtësisht italishten, ndërkohë që për Noemin procesi i të mësuarit ishte shumë i vështirë. Edhe integrimi i Noemit në klasë ishte më i ngadalshëm dhe më problematik se ai i së motrës. Motrat që flisnin greqisht me njëra-tjetrën, pas 7- 8 muajsh qëndrimi në Itali komunikojnë më shpesh italisht njëra me tjetrën. Rasti i Noemit e Esterit është një nga rastet tipike të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë të cilët nuk kanë arritur ta mësojnë shqipen në shtëpi.


Në pyetjen se çfarë gjuhe flasin në shtëpi, 16% e emigrantëve deklarohen italisht, 43% shqip dhe italisht dhe 41% shqip, 32% e grave dhe 52% e burrave përgjigjen shqip, 58% e grave dhe 26% e burrave përgjigjen italisht dhe shqip, 10% e grave dhe 22% e burrave përgjigjen italisht.

Shqipja ishte elementi i parë që emigrantët sakrifkuan për t'u integruar në shoqërinë e re. Emigrantët shqiptarë, shumë më tepër se të tjerët, e dinë se momenti i komunikimit është shumë i ngjashëm me atë të paraqitjes së pasaportës (Devole, 2005:1178). Gjuha shqipe shfaqet si faktori kryesor i 'dukshmërisë' për shqiptarët, përderisa nuk ka karakteristika të tjera 'rracore' apo dallime të mëdha kulturore


GJUHA NË SHTËPI



GJUHA NË SHTËPI (M)



GJUHA NË SHTËPI (F)



(Devole, 2005, Colombo 2009°, Vathi 2015). Në vitet e para të emigrimit shqiptar në Itali diskriminimi rracor ka pasur rol të jashtëzakonshëm në bjerrjen e gjuhës. Kjo vërehet te mospërdorimi i shqipes me fëmijët, veçmas kur ata janë në vitet e para të jetës.

Arsi (Rovigo, 48 vjeçe) Unë i kam lënë fëmijët në gjumë në mëngjes dhe ndonjëherë i kam gjetur në gjumë, kur jam kthyer nga puna. Nuk kam pasur kohë t'u mësoj atyre shqipen. Fëmijët e mi janë rritur në çerdhe nga suorat, deri në orën 18. Më vjen keq që nuk flasin shqip, por megjithatë ata e kuptojnë shqipen. Ndërkohë fëmijët e kunatit flasin shqip. Ata kanë gjyshërit në shtëpi.

Është e qartë se shqiptarët në Itali janë të orientuar drejt asimilimit gjuhësor, edhe pse nuk pëlqejnë ta pranojnë hapur. Në intervistat me prindërit na rrëfyon që edhe pse fëmijët e lindur në Shqipëri që kanë ardhur në moshë të vogël në Itali, kur flasin me të afërmit e tyre apo shokët shqiptarë përdorin italishten. Edhe statistikat tona e studimet tregojnë për shkallën e madhe të alternimit gjuhë e origjinës: gjuhë e huaj, sipas një diglosie që përcaktohet nga përmbajtja e bisedës, ku gjuha e origjinës shfaqet e reduktuar, minoritare në ambientin e ri. Në një ambient multikulturor ku dominuese është ideologjia e vendeve perëndimore dhe vlerat socio-ekonomike të globalizimit, politikat e asimilimit orientohen nga çrrënjësja apo modifikimi i identitetit etnik aq sa nënçmon apo izolon kulturën ideologjike që kushtëzohet nga përdorimi i një varieteti jostandard. Pra edhe funksionaliteti i gjuhës e bën italishten mjet më të përshtatshëm për t'u përdorur. Në të vërtetë, nëse do të vinim në plan të parë aspektin funksional të komunikimit, duhet ta pranojmë se gjuha shqipe u vlen pak emigrantëve, aq më tepër atyre që nuk kanë kontakte me bashkëkombasit (Devole, 2006:182).

Diskriminimi, dëshira për t'u integruar sa më shpejt në shoqëri dhe pa pasoja për fëmijët, orët e kufizuara që prindërit shqiptarë i kalojnë me fëmijët, veçmas kur janë nënat ato që punojnë me orë të gjata, janë faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në bjerrjen e shqipes te gjenerata e dytë e emigrantëve. Një faktor tjetër i rëndësishëm është se kur emigrantët kanë ardhur në Itali italishtja e tyre ka qenë bazike, shumë prej tyre kanë filluar ta mësojnë nëpërmjet fëmijëve. Rasti i Noemit dhe Esterit është edhe më i veçantë, pasi prindërit e tyre nuk flisnin fare italisht. Mospasja e një niveli të mirë gjuhësor ka ndikuar, sipas Vathit (2015), në krijimin e një barriere mes fëmijëve dhe prindërve, prindërit, duke mos qenë në gjendje t'u ndimonin fëmijëve në shkollë, kanë humbur nga autoriteti u tyre si edukatorë në sytë e fëmijëve. Nëse do t'i shtonim kësaj edhe faktin se komunikimi në familje në një gjuhë që zotërohet në nivel bazik është komunikim i limituar i cili krijon një barrierë mes fëmijëve dhe prindërve. Shqipja në familjet e emigrantëve transmetohet në mënyrë pasive nga komunikimi në shtëpi,


kjo bën që shqipja e fëmijëve të emigrantëve shqiptarë të jetë ajo dialektore dhe në përgjithësi e limituar në nivel komunikimi të thjeshtë.

Faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në bjerren e shqipes është se në vitet e para të emigrimit kontakti me familjarët në Shqipëri ka qenë mjaft i kufizuar. Bëjnë përjashtim familjet që kanë pasur gjyshër në shtëpi, të cilët kanë folur shqip me nipërit e mbesat. Është i njohur tashmë në literaturë roli pozitiv i gjyshërve ndaj ruajtjes së gjuhës, edhe pse në një familje mikse që kemi intervistuar, e cila prej 19 vitesh jeton me gjyshërit nga Shqipëria, të dy djemtë, njeri 17 dhe tjetri 19, identifikohen si italianë, ashtu si i ati e zotërojnë një shqipe mjaft pasive.


Wimmer (2008) thekson se diskursi akademik mbi konceptimin e etnicitetit ka evoluar drejt dy termave dikotomikë: 'primordializëm', i bazuar në idenë që përkatësia etnike fitohet në momentin e lindjes dhe si e tillë paraqet një karakteristikë 'të dhënë' të botës sociale dhe 'instrumentalizmin' që thotë se individët zgjedhin mes identiteteve të ndryshme atë që u intereson (Vathi, 2015: 38). Identiteti etnik përzgjidhet, sipas Nagel (1994), në bazë të perceptimit të individëve për audiencën, në disa kontekste hesht, në disa kontekste përdoret. Këtu luajnë rol edhe një sërë faktorësh të tjerë, si ata socioekonomikë, politikë, kulturorë të cilët ndikojnë që individët ta riformësojnë identitetin e tyre etnik, gjë që e bën identitetin etnik jostabil në kohë.

Në pyetjen që u kemi drejtuar emigrantëve nëse do t'u vinte keq nëse do të asimiloheshin, 70% e tyre përgjigjen po, 23% jo, 7% nuk dinë të përgjigjen.

JU VJEN KEQ TË ASIMILOHENI




JU VJEN KEQ TË ASIMILOHENI



Sikurse e kemi parë edhe në statistikat e tjera, gratë janë ato që më me lehtësi e pranojnë asimilimin qoftë gjuhësor, qoftë atë identitar. Është e njohur në sociolinguistikë sjellja e grave në rolin e klasave të mesme e të ulëta për dukurinë që quhet 'pasiguri gjuhësore' të studiuar nga Labov (1972:132, 134): Ndryshimi i shpeshtë stilistik i varianteve që tregohet nga klasa e ulët dhe e mesme, hiperndjeshmëria ndaj karakteristikave stigmatizuese të cilat ato vetë i përdorin dhe dhe perceptimi i pakuruar i të folurit të tyre, gjithçka na sjell në shkallën e pasigurisë gjuhësore...

pasiguria e madhe gjuhësore e këtyre folësve shpije te ndryshimet e shpeshta të normave të tyre në kontektet formale, madje edhe në moshën e mesme, ato kërkojnë të përdorin në gjuhë bartësit e prestigjit... Kjo i bën gratë e klasës së mesme dhe të ulët që të zgjedhin 'hiperkorrektizmin' në përdorimin e varianteve të prestigjit.

Në rastin e nënave emigrante shqiptare nuk vërejmë ndonjë dallim bazuar në nivelin e tyre të shkollimit, madje përqindja e nënave me PhD të cilat përgjigjen se nuk iu vjen keq të asimilohen është më e lartë se atyre që përgjigjen 'po'. Kjo na shtyn të mendojmë se asimilimi është proces më i shpejtë te gratë pa marrë parasysh nivelin e shkollimit, kjo mund të lidhet me rolin e tyre si edukatore të fëmijëve edhe si një mjet i efektshëm për integrim të shpejtë në shoqërinë vendase. Kultura italiane është parë gjithnjë si kulturë prestigji në Shqipërinë komuniste, gjë që e përshpejton procesin e asimilimit. Një faktor tjetër mund të jetë edhe mosrealizimi profesional i këtyre grave në Itali, që në shumicën e rasteve bëjnë punë të një niveli më të ulët sesa janë kompetencat e tyre profesionale.



Transmetimi i identitetit shqiptar nga prindërit te fëmijët sipas Vathit (2015) ka ndodhur në tri forma: e para, por vetëm në shumë pak raste fëmijët tregojnë se prindërit e tyre i kanë inkurajuar të mësojnë mbi historinë dhe traditat e shqiptarëve; së dyti, prindërit me vetëdije kanë vendosur të mos ua transmetojnë identitetin e tyre fëmijëve, nuk i shpien në Shqipëri për vizitë etj, shkak i diskriminimit të egër që ata kanë përballuar; së treti, prindërit pretendojnë që fëmijët e tyre të identifikohen simbolikisht si shqiptarë, duke ruajtur disa nga traditat dhe institucionet sociale, veçanërisht familjen. Në gjendjen e sotme, kur rrjetet sociale dhe mediat shqiptare ndiqen më shumë nga familjet shqiptare, ndihet një afrim i gjeneratës së dytë me identitetin e prindërve të tyre, por barrierat që janë krijuar në fëmijëri vazhdojnë të mbeten të tilla. Në një shikim të faqeve të facebook-ut të të rinjve shqiptarë që kemi intervistuar, nuk gjetëm asnjë postim në shqipe. Arsye mund të jenë që nga mosnjohja e shqipes së shkruar apo ngurrimi për të shkruar një shqipe me gabime, deri te mungesa e një ndërveprimi me moshatarët me të njëjtin identitet etnik.

Endri, 32 vjeçar nga Pisa, që është kthyer në Tiranë për studime universitare, ku edhe mësoi shqipen akademike, thotë se as ai nuk e di më se çfarë është, nuk e klasifikon dot veten si shqiptar, por as më si italian.

Përfundim

Ajo që mund të nxjerrim si përfundim nga evokimi i historisë së arbëreshëve në Itali, dallimi mes tyre e arvanitasve në Greqi, është se thirrja në identitetin etnik e kulturor të përbashkët nuk solli asgjë në terrenin konkret të solidarizimit me emigrantët e rinj shqiptarë të ardhur ne vitet '90. Sikurse pohon Luckman e Berger (1966) identiteti i popujve, apo identiteti etnik që i lidh njerëzit në bazë të origjinës së lindjes, nuk përcaktohet një herë e përgjithmonë, por ndërtohet në kohë, modifikohet apo riformësohet. Identiteti arbëresh i ndërtuar për pesë shekuj në Itali nuk mund të ketë aq shumë të bërëbashkëta me atë shqiptar, të dyja grupet kanë zhvilluar një vizion për botën dhe për jetën të ndryshëm.

Gjuha shqipe konsiderohet si një nga elementët themelorë të identitetit të shqiptarëve, mbi të cilën u ngrit thuaj gjithë procesi i vetëdijësimit kombëtar gjatë periudhës së Rilindjes. Por gjendja e shqipes të gjenerata e dytë e emigrantëve sot në Itali na dëfton për një identitet të lëkundur e të brishtë, ku vetëm gjuha nuk mjafton.

Përballja me një diskriminim të fortë rracor në fillim të viteve '90, krijuar mbi të gjitha falë mitit mediatik 'albanese' shenjo i fillimin e procesit të zhvlerësimit apo të fshehjes së identitetit të emigrantët, që e futi shqipen në proces të shpejtë asimilimi.

Fakti që fluksi i ardhjes së shqiptarëve në Itali e në vendet e tjera nuk është ndërprerë, tregon për një jostabilitet ekonomik, social e politik në vend, gjë që bën që Shqipëria ende të mos duket si vend i dëshirueshëm për të jetuar për emigrantët, qoftë edhe në një të ardhme. Ky është një faktor tjetër i rëndësishëm që e ndihmon procesin e asimilimit gjuhësor.

BIBLIOGRAFIA

Altimari F. 1986, "Profili storico-letterari", in Altimari *et alii*: 1-31.

Altimari F., M. Bolognari e P. Carrozza 1986, *L'esilio della parola*, ETS, Pisa.

F.Altimari e L.M. Savoia 1994, *I dialetti italo-albanesi*, Roma, Bulzoni.

Berger L. P. & Luckman T., [1966] 1991, *The Social Construction of Reality*, Penguin Books.

Bernstein B. 1971, *Class, Codes and Control. v.I*, Routledge & Kegan, London.

- Bolognari M. 1986, "Profili antropologici", in Altimari F. *et alii*:33-113.
- Bolognari M. (a cura di) 1989, *La diaspora della diaspora*, ETS, Pisa
- Brunetti C. 1985, *La condizione giuridica delle minoranze linguistiche*, Edizioni Vatra, Cosenza.
- Candrea C. e Stamile C. 1979, *Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh*, Dipartimento di Scienze dell'Educazione dell'Università della Calabria,
- Carrozza P. 1986, "Profili giuridico-istituzionali", in F. Altimari et al. *L'esilio della parola*, ETS, Pisa: 115-217
- Carrozza P. 1989, "La situazione attuale in Italia", in *Revista de Llengua i dret*, Generalitat de Catalunya, Escola d'Amministració Pública de Catalunya: 111-134
- Carrozza P. 1992, "Stati nazionali, multiculturalismo, diritti scolastici e culturali. Il punto di vista giuridico-istituzionale, in Tassinari et al., p.151-165.
- Çabej E. 1976 e 1977, "Gli italo-albanesi e le loro parlate" in Zjarri VIII: 18-25 e IX: 3-12
- Chomsky N. 1977[1970], *Per ragioni di stato*, Einaudi, Torino.
- Chomsky N. 1986, *Knowledge of Language. Its nature, Origin, and Use*, Praeger, New York.
- Chomsky N. 1988, *Language and Problems of Knowledge*, The MIT Press, Cambridge Mass.
- Cocchi G., M. Giusti, M.R. Manzini, T. Mori, L.M. Savoia 1996, *L'italiano come L2 nella scuola dell'obbligo. Il formarsi della competenza linguistica in bambini cinesi e rom*, Roma, Bulzoni
- Coveri L. 1981-82, "Dialecto e scuola nell'Italia unita", in *Rivista Italiana di Dialettologia*, 5: 77-97.
- De Leo P. 1981, "Condizioni economico-sociali degli albanesi in Calabria tra XV e XVI secolo", in *Miscellanea di studi storici*, Università della Calabria, Brenner, Cosenza: 123-142.
- Dell'Erba N. 1997, *Storia dell'Albania*, Neëton Compton, Roma
- De Mauro T. 1986, "Prefazione", in F. Altimari, M. Bolognari, P. Carrozza 1986, *L'esilio della parola*, ETS, Pisa: vii-xii
- De Mauro T., S. Gensini, T. Leto e E. Passaponti 1980, *Lingua e dialetti nella cultura italiana da Dante a Gramsci*, Casa Editrice G. D'Anna, Messina-Firenze.

- Devole R., 2006, *L'immigrazione albanese in Italia*, Agrilavoro Edizioni.
- Devole R. & Vehbiu A., 1996, *La scoperta dell'Albania, Gli albanesi secondo la mass media*, Paoline.
- Doxa 1992, "Parlare in dialetto", in *Bollettino della Doxa*, XLVI, n. 9-10: 77-92.
- Famiglietti M. 1979, *Educazione e cultura in Arberia*, Bulzoni, Roma.
- Faraco G. 1976, "Gli albanesi d'Italia", in U. Bernardi (a cura di), *Le mille culture. Comunità locali e partecipazione politica*. Coines Edizioni, Roma: 194-211
- Gambarara D. 1980, "Parlare albanese nell'Italia unita", in *Zjarri* 27: 49-67.
- Gangale G. 1976, *Lingua arberisca restituenda. Dichiarazioni di principio del Centro greco-albanese di glottologia di Crotone sul problema dell'albanese nelle scuole*, Centro greco-albanese di glottologia di Crotone.
- Giacomarra M. 1993, «Ricareare etnicità. Costruzione d'identità fra gli albanesi di Sicilia», in AA.VV. *Gli albanesi d'Italia e la Rilindja albanese*, Università di Palermo e Centro internazionale di Studi albanesi, Palermo
- Giacomarra M., *Immigrati e minoranze*, La Zisa, Palermo 1994.
- Giacomarra M. 2000, *Migrazioni e identità. Il ruolo delle comunicazioni*, Palombo, Palermo.
- Gramsci A. 1975, *Quaderni dal carcere*, v. II, Einaudi, Torino
- Grilli F. 1992/93, *Le minoranze linguistiche in Italia oggi. Stampa nazionale ed aspetti giuridici*, Tesi, Università di Firenze
- ISTAT (a cura di F. Panizon) 1992, *Indagine multiscopo sulle famiglie. Anni 1987-91*, 7 Letture, Mass Media e Linguaggio
- ISTAT 1997, "Lingua italiana e dialetti" (S. Gazzelloni), in *Note rapide*, 2, 1
- ISTAT 2013 https://www.istat.it/it/files//2013/12/Notadiffusione_stranieri20122013.pdf
- ISTAT 2017 https://www.istat.it/it/files//2013/10/Rapporto_annuale_2017_Ilpost.pdf
- Jackendoff R. 1998 [1993], *Linguaggio e natura umana*, il Mulino, Bologna
- Klein G. 1986, *La politica linguistica del fascismo*, Il Mulino, Bologna
- Labov W. 1972a, *Language in the Inner City*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.

- Labov W. 1972b, *Sociolinguistic patterns*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
- Lenneberg E.H. 1971[1967], *Fondamenti biologici del linguaggio*, Boringhieri, Torino.
- Mandalà M. 2006, Costruizioni d'identità e falsificazioni, il caso di Demetrio Reres, "La Sicilia, il Mediterraneo, i Balcani, storia culture, lingue, popoli", pg 35-53, Atti delle Giornate di Studio -Palermo
- Pizzorusso A. 1983, "L'attuazione del principio costituzionale di tutela dei gruppi linguistici in Italia", in A. Guzzetta (a cura di), *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia. Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi*, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Università di Palermo: 11-25
- Pizzorusso A. 1993, *Minoranza e maggioranze*, Einaudi, Torino
- Russo D. 1993, "L'ultima rilevazione", in *Italiano e oltre* VIII:158-163.
- Salvi S. 1975, *Le lingue tagliate. Storia delle minoranze linguistiche in Italia*, Milano, Rizzoli.
- Savoia L.M. 1983, "Assetto della grammatica e realizzazione sociale nel cambiamento linguistico: un esempio di variazione morfologica in una varietà arbëreshe", in *Quaderni dell'Istituto di Linguistica dell'Università di Urbino*, 1:25-67.
- Savoia L.M. 1985, "Per una educazione arbëresh" in AA.VV. *Le minoranze etniche e linguistiche*, Atti del 1° Congresso internazionale, Comune di Piana degli Albanesi, Facoltà di Lettere e Filosofia dell'Università di Palermo e Facoltà di Lettere e Filosofia dell'Università della Calabria, Palermo: 211-231.
- Savoia L.M. 1986, "Sistemi flessionali e cambiamento morfologico: affinità grammaticali e condizioni della variazione in alcuni dialetti arbëreshë", in *Quaderni dell'Istituto di Linguistica dell'Università di Urbino*, 4, pp. 115-174.
- Savoia L.M. 2000a, "I dialetti, le lingue di minoranza e la lingua standard nella cultura italiana", in V.A. Martella e G. Carducci (a cura di) *Le comunità italo-albanesi fra microstoria e arbëreshe: il caso di San Marzano*, S.Marzano: 17-48
- Savoia L. M. 2000b, "L'educazione linguistica in una lingua minoritaria: l'arbëresh di Piana", in P. Manali (a cura di) *Skanderbeg 3000. Atti del seminario*, Comune di Piana degli Albanesi: 19-39
- Sciascia L. 1992, *Fuoco all'anima. Conversazioni con Domenico Porzio*, Milano, Mondadori

- Sobrero A. 1974, "Il problema delle minoranze linguistiche in Italia", in AA.VV. *I diritti delle minoranze etnico linguistiche*, Cisalpino-Goliardica, Milano, pp.13-30.
- Tassinari G., G. Ceccatelli Gurrieri e M. Giusti 1992, *Scuola e società multiculturale. Elementi di analisi multidisciplinare*, La Nuova Italia, Firenze.
- Telmon T. 1992, *Le minoranze linguistiche in Italia*, Alessandria, Edizioni dell'Orso.
- Vathi Z. 2015, Migrating and Settling in a Mobile World, Albanian Migrants and Their Children, IMISCOE
- <http://www.monitor.al/shqiperia-ben-gati-valixhet-duan-te-ikin-te-arsimuarit-dhe-ata-me-paga-mbi-1000-euro/>